



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 12.08.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. RABIJE SALLAHI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Afërdita Shehi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Rabije Sllahi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 04.08.2020, nr.704/2020, për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit Komunal znj. Afërdita Shehi, pas dorëheqjes së saj përvokueshme nga pozita e anëtares së Kuvendit të Komunës, për të udhëtimit jashtë vendit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur e cila është znj. Rabije Sallahi, ka dhënë deklaratën e pranimin të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 12.08.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka